

L I G J
Nr.9603, datë 28.7.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN “CILËSI DHE BARAZI NË ARSIM””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Cilësi dhe barazi në arsim””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5023, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE FINANCIIMI

MARRËVESHJE e datës _____ 2006 ndërmjet Shqipërisë (Marrësi) dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (Shoqata). Marrësi dhe Shoqata janë marrë vesh për sa më poshtë:

Neni 1

Kushte të përgjithshme; përkufizime

Seksioni 1.01 Kushtet e përgjithshme (siç janë përcaktuar në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02 Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në Marrëveshjen e financimit kanë kuptimin përkatës që iu është dhënë në kushtet e përgjithshme apo në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Financimi

Seksioni 2.01 Shoqata bie dakord t'i japë hua Marrësit, sipas termave dhe kushteve të parashtruara ose të cilave u referohet kjo Marrëveshje, një shumë kredi me një vlerë prej dhjetë milionë e pesëqind mijë Të Drejta Speciale Tërheqjeje/ (Special Drawing Rights) (SDR 10,500,000)¹ (“Kredia”) për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në programin 1 të kësaj Marrëveshjeje (“Projekti”).

Seksioni 2.02 Shuma e kredisë mund të tërhiqet nga Marrësi në përputhje me kushtet e pjesës

¹ LOA do të transferojë shumën e kredisë në SDR.

V të programit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.03 Marrësi do t'i paguajë Shoqatës një normë maksimale pagese angazhimi mbi shumën kapitale të Kredisë të patërhequr, në masën sa gjysma e një për qind (1/2 e 1 %) në vit.

Seksioni 2.04 Marrësi do t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi në normën tre të katërtat e një për qind (3/4 e 1%) në vit mbi shumën kapitale të kredisë së tërhequr dhe të papaguar.

Seksioni 2.05 Tarifat e angazhimit dhe të shërbimit do të paguhet dy herësh, më 1 mars dhe 1 shtator² të çdo viti.

Seksioni 2.06 Marrësi do të shlyejë shumën kapitale të kredisë në përputhje me programin e ripagimit të përcaktuar në programin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.07 Monedha e pagesës është euro.

Neni 3 Projekti

Seksioni 3.01 Marrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Marrësi, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës do të kryejë Projektin siç është parashtruar në dispozitat e nenit 4 të kushteve të përgjithshme të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Pa asnjë kufizim apo pengesë prej dispozitës së seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe me përjashtim të rastit kur Marrësi dhe Shoqata janë marrë vesh ndryshe, Marrësi do të sigurojë që Projekti kryhet në përputhje me dispozitat e programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4 Zgjidhjet ligjore të Shoqatës

Seksioni 4.01 Ngjarjet shtesë të ndërprerjes konsistojnë si më poshtë:

a) Një situatë që mund të jetë krijuar, e cila e bën të pamundur zbatimin e programit ose të një pjese të rëndësishme të tij.

b) (i) Subjekt i nënparagrafit (ii) të këtij paragrafi: (A) të jetë pezulluar, anuluar apo përfunduar, tërësisht apo pjesërisht, e drejta e Marrësit për tërheqjen e fondit të çdo huaje apo grantit të akorduar për bashkëfinancimin e Projektit, në bazë të kushteve të Marrëveshjes për Grantin Bashkëfinancues; dhe (B) çdo huadhënie e tillë do të jetë bërë efektive dhe e pagueshme para datës së maturimit për të cilën është rënë dakord.

(ii) Nënparagrafi (i) të këtij paragrafi nuk do zbatohet nëse Marrësi vërteton në mënyrë të pranueshme për Shoqatën se: (A): pezullimi, anulimi apo përfundimi i përmendur më sipër nuk është shkaktuar nga mospërbushja nga ana e Marrësit e detyrimeve të marra përsipër në bazë të Marrëveshjes për Grantin Bashkëfinancues; dhe (B) Marrësi ka në dispozicion të tij fonde të mjaftueshme për Projektin nga burime të tjera të akorduara në bazë të kushteve kontraktuale që nuk bien në kundërshtim me detyrimet e Marrësit që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

c) Marrësi nuk ka përbushur ndonjë nga detyrimet e tij të marra përsipër në bazë të Marrëveshjes për bashkëfinancimin e Projektit.

Seksioni 4.02. Ngjarjet shtesë të ndërprerjes konsistojnë në atë që rastet e përcaktuara në paragrafët (b) dhe (c) të seksionit 4.01 të kësaj Marrëveshjeje të vërtetohet dhe të vazhdojë për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh mbas lajmërimit që Shoqata i jep Marrësit për vërtetimin e ngjarjes në fjalë.

Neni 5 Data e hyrjes në fuqi; përfundimi

Seksioni 5.01 Ngjarjet e mëposhtme përcaktohen si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Financimit:

a) Manuali Operacional i Projektit është pranuar nga Marrësi;

² Për datat e pagesës do të bien dakord gjatë negociatave.

b) Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe Drejtoria e Ekonomike në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, duhet të kenë një staf të pranueshëm nga Shoqata, duke përfshirë emërimin e një drejtori për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm dhe emërimin e të paktën një stafi me kohë të plotë për Drejtorinë Ekonomike që do të merret me menaxhimin financiar të PVR-së (Programit Vjetor të Reformës).

c) Plan i për Zhvillimin e Kapaciteteve të Besueshmërisë është përgatitur.

Seksioni 5.02. Data që bie nëntëdhjetë (90) ditë mbas datës së lidhjes së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet si data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Përfaqësuesi i Marrësit; adresat

Seksioni 6.01 Ministri i Financave i Marrësit ngarkohet me detyrën e përfaqësuesit të Marrësit.

Seksioni 6.02. Adresat:

Për Marrësin:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" -

Tiranë, Shqipëri

Faks: 3554 228494

Për Shoqatën për Zhvillim Ndërkombëtar:

International Development Association

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433,

United States of America

Adresa a Kabllit:Teleks:

Faks:

INDEVAS

248423 (MCI) (202)

477-6391

Washington D.C.

64145 (MCI)

Palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruajnë këtë Marrëveshje me emrat e tyre përkatës, në datën dhe vitin e treguar më sipër.

PROGRAMI 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Pikësynimet e projektit janë në mbështetje të programit të Marrësit: (a) për të përmirësuar cilësinë e kushteve të mësimdhënies për studentët; (b) për të rritur regjistrimin në shkollë (ndjekjen e shkollës) nga studentët e arsimit të mesëm; dhe (c) për të filluar reformën në arsimin e lartë.

Projekti konsiston në pjesët që vijojnë, të cilat janë subjekt për ndryshime për të cilat Marrësi dhe Shoqata do të bien dakord herë pas here në funksion të arritjes së objektivave:

Pjesa A. Forcimi i menaxhimit, lidhshimit dhe qeverisjes në sistemin arsimor

Veprimtaritë e synuara për të fuqizuar lidhshimin dhe kapacitetet e menaxhimit, si dhe për të përmirësuar qeverisjen dhe përgjegjshmërinë në sektorin e arsimit, përfshijnë:

1. zhvillimin dhe zbatimin e trajnimeve për lidhshimin dhe programin e zhvillimit profesional për drejtorët e shkollave;

2. përgatitjen e manualit për grantet e akorduara për përmirësimin shkollave dhe përzgjedhjen e shkollave pjesëmarrëse;

3. trajnimin e autoriteteve lokale dhe rajonale arsimore mbi reformën në arsim;

4. përmirësimin e kapaciteteve të besueshme në MASH, në zyrat rajonale dhe lokale të arsimit;

5. trajnimin e punonjësve të financës dhe prokurimeve në nivel qendror, rajonal dhe lokal;

6. përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të Qendrës Arsimore për

Trajnim dhe Kualifikim, Institutit të Kurrikulave dhe Standardeve, si dhe Qendrës Kombëtare për Vlerësim;

7. përgatitjen dhe organizimin e takimeve gjashtëmujore me partnerët për zhvillimin; si dhe
8. pilotimin e shpërndarjes së decentralizuar të shërbimit të arsimit dhe një programi prezantues për shpërndarjen e decentralizuar të shërbimit arsimor.

Pjesa B. Përmirësimi i cilësisë së rendimentit mësimor

Veprimtaritë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në sistemin arsimor parauniversitar përfshijnë:

1. prezantimin dhe zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies, kurrikulave dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm;

2. prezantimin dhe zbatimin e një programi për kualifikim profesional për mësuesit;

3. përgatitjen e një manuali për një rrjetet të përmirësimit të shkollave dhe përzgjedhjen e shkollave të cilat do të marrin pjesë;

4. prezantimin dhe zbatimin e një vlerësimi paraprak për 15-vjeçarët, në lëndët e matematikës, gjuhës shqipe dhe shkencave;

5. zbatimin e një trajnimi gjatë punës për mësuesit e shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm dhe dhënia e granteve të kushtëzuara për trajnimet gjatë punës për shkollat të cilat i përmbushin kriteret e përzgjedhjes të cilësuar në MO;

6. dhënien e granteve për përmirësimin e shkollave, për shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, sipas kriterëve të cilësuar në MO;

7. dhënien e asistencës teknike dhe për zbatimin e kurrikulave të reja për arsimin e mesëm;

8. përgatitjen e një politike kombëtare për vlerësimin e rezultateve në arsim; si dhe

9. pjesëmarrjen në studimin PISA 2009, duke përfshirë trajnimin dhe testimin nëpër shkolla, si dhe për zbatimin dhe përhapjen e studimit PISA 2009.

Pjesa C. Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore

Veprimtaritë për përmirësimin dhe racionalizimin e infrastrukturës arsimore përfshijnë:

1. përgatitjen dhe përditësimin e vazhdueshëm të hartës së shkollave dhe inventarit të ambienteve arsimore;

2. zhvillimin e kriterëve për rehabilitimin e shkollave dhe ndërtimi i shkollave të reja;

3. zhvillimin dhe përmirësimin e standardeve për klasat e mësimi dhe ambjentet e tjera në shkollat fillore dhe të mesme;

4. përmirësimin e mekanizmit të alokimit dhe rialokimit për buxhetin e Marrësit, për investimet në arsim;

5. dhënien e granteve specifike për investime në arsim për rajonet të cilat përmbushin kriteret e vendosura në MO;

6. dhënien e granteve për pajisje për laboratorët e shkencës dhe informatikës, si dhe materiale të tjera shkollore për shkollat për përmbushjen dhe kriteret e vendosura në MO;

7. nxitjen e pjesëmarrjes së komunitetit në mbikëqyrjen e rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së shkollave; si dhe

8. zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie për rritjen e regjistrimeve të nxënësve në shkollat e mesme.

Pjesa D. Modernizimi i sistemit për arsimin e lartë

Veprimtaritë për zhvillimin dhe fillimin e zbatimit të një strategjie për reformën në sistemin e arsimit të lartë përfshijnë:

1. organizimin e takimeve ndërmjet partnerëve për draftin e Master Programit për Arsimin e Lartë;

2. mbështetje për përgatitjen dhe zbatimin e një amendamenti draft për ligjin për arsimin e lartë në përputhje me draftin e Master Programit për Arsimin e Lartë;

3. finalizimin dhe zbatimin e Master Programit për Arsimin e Lartë;

4. prezantimin dhe zbatimin e një programi kualifikimi në nivel universiteti për mësuesit në shkollat e arsimit bazë;

5. prezantimin dhe zbatimin e një programi veprimi për zbatimin e procesit të Bolonjës;

6. themelimin e bordeve drejtuese në universitete; si dhe

7. prezantimin dhe zbatimin e planeve për zhvillimin strategjik për universitetet individuale.

PROGRAMI 2 ZBATIMI I PROJEKTIT

PJESA I MARRËVESHJET INSTITUCIONALE

Marrësi do t'i qëndrojë besnik marrëveshjeve institucionale gjatë gjithë kohëzgjatjes së Projektit:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të jetë përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm të Projektit, duke përfshirë vendosjen e prioriteteve dhe koordinimin e veprimtarive të Projektit, përgatitjen e programeve vjetore për reformën dhe monitorimin e mjeteve mbrojtëse dhe të besueshme, siç është paraqitur në MO.

2. Këshilli Drejtues i Projektit do të jetë përgjegjës për politikën dhe mbikëqyrjen e Projektit. Anëtarët që do të përbëjnë këtë Këshill do të jenë Ministri dhe Zv/Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Këshilltari i Kryeministrit, Zv/Ministri i Financave, Zv/Ministri i Brendshëm dhe i Decentralizimit, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i MASH.

3. Sekretari i Përgjithshëm i MASH do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e veprimtarive të Projektit në nivel teknik. Drejtorët e caktuar në drejtoritë brenda MASH dhe stafi i Qendrës së Kualifikimit dhe Trajnimit për Arsimin, Institutit të Kurrikulave dhe Standardeve, si dhe Qendrës Kombëtare për Vlerësimin dhe Provimet, do të jenë përgjegjës për zbatimin e veprimtarive specifike të Projektit, siç janë parashikuar në MO.

PJESA II MARRËVESHJET E ZBATIMIT

Marrësi do të zbatojë: të gjitha detyrimet e tij në përputhje me MO (Manualin e Operacioneve), PMM (Programin e Menaxhimit Mjedisor) dhe MM (Memorandumin e Mirëkuptimit) dhe nuk do të ndryshojë, pezullojë, anulojë, shfuqizojë ose të heqë ndonjë nga parashikimet e Manualit të Operacioneve, PMM-së apo MM, pa marrë aprovimin më parë nga Shoqata.

2. Nëpërmjet MASH, Marrësi:

a) jo më vonë se 15 shtatori i çdo viti përgjatë zbatimit të Projektit, duke filluar nga 15 shtator 2006, do të përgatisë programin vjetor për Reformën për vitin kalendarik që vijon, i përgatitur ky në përputhje me formatin e përfshirë në Manualin Operacional do t'i dorëzohet Shoqatës për vlerësim dhe aprovim dhe do të bihet dakord me Shoqatën për hapat që duhet të ndërmerren në vitin kalendarik pasues; si dhe

b) jo më vonë në data 15 prill e çdo viti përgjatë zbatimit të Projektit, duke filluar nga 15 prill 2007, do të përgatisë një raport të performancës për Programin Vjetor për Reformën për vitin kalendarik të mëparshëm dhe një program i përgjithshëm, i monitoruar sipas treguesve dhe kushteve të monitorimit të caktuara në Manualin Operacional do t'i dorëzohet/dërgohet Shoqatës; dhe

c) së bashku me Shoqatën do të kryejë një vlerësim të veprimtarive të Projektit, i bazuar në raportin e përmendur në nënparagrafin e mësipërm (b).

3. Marrësi do të kryejë një vlerësim operacional që mbulon vitin e kaluar kalendarik, i cili duhet të ndërmerret dhe të përfundohet nga revizorë të pavarur të pranuar dhe nga Shoqata në bazë të termave të referencës të pranueshme prej Shoqatës, çdo vit gjatë zbatimit të Projektit. Një raport i tillë duhet të mbulojë kuadrin e kontrollit të brendshëm dhe procedurave të Marrësit duke përfshirë proceset e prokurimit dhe sistemin e menaxhimit financiar për sektorin e arsimit të Marrësit, dhe duhet të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Revizionimit (ISA) dhe sipas termave të referencës të pranuar nga Shoqata. Rezultatet dhe gjetjet e revizionimit dhe vlerësimit duhet t'i

dorëzohen Shoqatës në datën 15 prill të çdo viti, gjatë periudhës së zbatimit të Projektit, duke filluar që prej 15 prill 2008. Revizionimi i parë dhe rezultatet e tij duhen dorëzuar në 15 prill 2008, do të mbulojnë vitet kalendarike 2006 dhe 2007.

4. Nëse si rezultat i raportimeve, duke iu referuar paragrafëve (2) (b) dhe (3) të seksionit II, Shoqata vendos në çdo kohë që procedimet e kredisë nuk janë përdorur për financimin e Shpenzimeve të Ligjshme sipas Programit Vjetor për Reformën përkatëse, ose nuk kanë qenë të justifikuara, atëherë Shoqata mundet që: (a) t'i kërkojë Marrësit t'i rifinancojë Shoqatës një shumë të barabartë me shumën e përdorur për shpenzime jo të ligjshme ose të pajustificuara; ose (b) të ulë pjesën e saj të financimit për veprimtaritë sipas Programit Vjetor për Reformën në lidhje me shumën e përdorur për shpenzime jo të ligjshme dhe të pajustificuara.

5. Marrësi duhet që, jo më vonë se 1 janari i çdo viti përgjatë periudhës së zbatimit të Projektit, duke filluar që prej 1 janar 2007 duhet që të përfshijë në buxhetin e tij të përgjithshëm një shumë/vlerë që mbulon pjesën e tij të Programit Vjetor për Reformën për vitin kalendarik respektiv.

6. Jo më vonë se data 1 janar 2007, Marrësi duhet të ketë hyrë në Marrëveshjen e Bashkë Financimit të EIB dhe Marrëveshjen e Bashkëfinancimit të CEDB.

7. Jo më vonë se data 1 janar 2007, Marrësi duhet të ketë nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi me Shoqatën, Bankën Europiane të Investimeve dhe Bankën e Këshillit të Zhvillimit Europian në lidhje me mbështetjen financiare të përbashkët për Projektin.

8. Marrësi, nëpërmjet MASH, do të organizojë dhe kryesojë dy herë në vit një takim, respektivisht në maj dhe tetor, dhe sipas nevojës dhe rastit. Gjatë takimeve të majit të çdo viti, duhen revizuar Projekti dhe PVR për vitin e kaluar. Gjatë mbledhjeve të mbajtura në tetor të çdo viti, PVR e vitit të ardhshëm, duke përfshirë shumat e nevojshme për zbatimin e veprimtarive në kuadër të programeve vjetore për reformën, duhet rënë dakord. Këto takime do të kryesohen nga MASH dhe pjesëmarrësit në to do të jenë nëpunës të lartë brenda MASH, Minsitrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme dhe Decentralizimit, Ministrisë së Punëve dhe Çështjeve Sociale, këshillat e qarkut, drejtoritë rajonale arsimore në nivel qarku dhe rrethi, si dhe përfaqësues të partnerëve për Zhvillim dhe partnerëve/stakeholderave të tjerë.

PJESA III MONITORIMI I PROJEKTIT, RAPORTIMI, VLERËSIMI

A. Raportet e Projektit.

1. Marrësi duhet të monitorojë dhe të vlerësojë zhvillimin e Projektit dhe të përgatisë raportet e Projektit në përputhje me parashikimet e kushteve të përgjithshme, seksioni 4.08 dhe në bazë të tregu të pranuar (rënë dakort nga Shoqata. Çdo raport projekti do të hartohet për një periudhë gjashtëmujore dhe duhet t'i jepet Shoqatës jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të periudhës të këtij raporti.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe auditimi.

1. Marrësi duhet të mbajë ose do të sigurojë mbajtjen e një sistemi menaxhimi financiar në përputhje me dispozitat në kushtet e përgjithshme, seksioni 4.09.

2. Pa asnjë lloj kufizimi sipas parashikimeve e pjesës A të këtij seksioni, Marrësi duhet të përgatisë dhe t'i dërgojë Shoqatës në datat 30 qershor dhe 31 dhjetor të çdo viti, raporte financiare të përvizionuara, të cilat janë të ndërmjetme/progresive për projektin duke mbuluar periudhën përkatëse prej gjashtë muajsh, në formën dhe përmbajtjen në mënyrë që është e pranueshme dhe nga Shoqata.

3. Marrësi duhet të ketë bilanci financiar të revizionuara në përputhje me parashikimet e kushteve të përgjithshme si te pjesa 4.09 (b). Çdo revizionim i bilanceve financiare të Marrësit do të bëhet për një periudhë njëvjeçare (viti financiar), duke filluar me vitin financiar në të cilin është bërë tërheqja e parë për projektin. Bilanci financiar të revizionuara për secilën nga këto periudha duhet t'i dërgohen/jepen Shoqatës jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit kësaj periudhe.

PJESA IV PROKURIMET

A. Të përgjithshme

1. Mallrat dhe punimet. Të gjitha mallrat dhe punimet që nevojiten për Projektin dhe që do të financohen jashtë të ardhurave të financimit do të prokurohen në përputhje me kërkesat që përcaktohen apo që referohen në seksionin I të Udhëzimeve të Prokurimeve, dhe me dispozitat e këtij Programi.

2. Shërbimet e Konsulencës. Të gjitha shërbimet e konsulencës që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen jashtë të ardhurave të financimit, do të prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të referuara në seksionin I dhe IV të Udhëzimeve të Konsulentëve dhe me dispozitat e këtij programi.

3. Përkufizime. Termat me shkronja të mëdha të përdorura më poshtë në këtë seksion, për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi të kontratave të veçanta nga ana e Shoqatës, sipas rastit, i referohen metodës korresponduese të përshkruar në Udhëzimet e Prokurimit ose Udhëzimet e Konsulentëve.

B. Metoda të veçanta për prokurimin e mallrave dhe punimeve

1. Tender i hapur ndërkombëtar. Përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në paragrafin 2 që vijon, mallrat dhe punimet do të prokurohen sipas kontratave të hartuara mbi bazën e tenderimit të hapur ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera për prokurimin e mallrave dhe punimeve. Tabela e mëposhtme specifikon metodat e prokurimit, të ndryshme nga tenderat e hapur ndërkombëtarë, procedura të cilat mund të përdoren për mallra dhe punime. Programi i prokurimit do të specifikojë rrethanat nën të cilat mund të përdoren këto metoda:

Metodë/mënyrë prokurimi

- a) Tender i hapur kombëtar - me modifikimet e parashikuara/përshkruara në paragrafin 3 më poshtë;
- b) Blerje; dhe
- c) Kontraktim direkt

3. Procedurat e tenderimit të hapur kombëtar do të bazohen mbi procedurat e tenderimit të hapur të përcaktuara në ligjin shqiptar për prokurimin publik, si dhe në parashikimet e tjera që vijnë më poshtë:

i) procedurat për “Tenderimin e hapur” të parashikuara në ligjin shqiptar për prokurimin publik do të aplikohen për të gjitha kontratat;

ii) gjatë procesit të tenderimit, pjesëmarrësit/ofertuesit e huaj në tender nuk do të përjashtohen nga tenderi dhe asnjë preferencë e asnjë lloji nuk do t’i jepet ofertuesve kombëtarë. Ndërmarrjet publike (në pronësi të qeverisë) në Shqipëri do të lejohen të marrin pjesë në tender në rast se ato janë ligjërish dhe financiarisht autonome dhe operojnë sipas legjislacionit tregtar të Huadhënësit;

iii) entet prokuruese do të përdorin modele tip dokumentesh (standarde) tenderi të miratuara nga Shoqata;

iv) në rastet kur çmimet e ofertës janë më të larta se llogaritjet zyrtare, të gjitha ofertat nuk do të refuzohen pa rënë dakord më parë me Shoqatën;

v) për dorëzimin e ofertave do të përdoret procedura me një zarf të vetëm;

vi) postkualifikimet do të kryhen vetëm mbi ofertuesin me ofertën më të ulët; asnjë ofertë nuk do të refuzohet për shkaqe kualifikimi në kohën e hapjes së ofertave;

vii) ofertuesit të cilët kontraktohen si një *joint-venture* do të kenë përgjegjësi ligjore të përbashkët dhe të pandarë;

viii) kontratat do të jepen/do të bëhen të vlefshme për ofertën të cilësuar si më të ulët, ofertuesin më të shpejtë, i cili është i vendosur për t’u kualifikuar dhe për të vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit të paracaktuara dhe të paraqitura më parë.

ix) negociatat pas tenderimit nuk do të lejohen as me ofertuesin me ofertën më të ulët, as me ndonjë ofertues tjetër; si dhe

x) kontratat afatgjata (më të gjata se 18 muaj) do të përmbajnë parashikimet e duhura për ndryshimin e çmimeve.

C. Metoda të veçanta për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja e bazuar mbi koston dhe cilësinë. Përveç rasteve kur cilësohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulencës do të prokurohen nën kontratat e dhëna mbi bazën e përzgjedhjes të bazuar mbi cilësinë dhe koston.

2. Metoda të tjera të Prokurimit të Shërbimeve të konsulencës. Tabela e mëposhtme specifikon/cilëson mënyrat e prokurimit, të ndryshme nga përzgjedhja e bazuar në koston dhe cilësinë, e cila mund të përdoret për shërbimet e konsulentëve. Programi i prokurimeve do të specifikojë rrethana në të cilat mund të përdoren mënyra/metoda të tilla.

Metodë prokurimi

- a) Përzgjedhja e koston më të ulët;
- b) Përzgjedhja e bazuar mbi kualifikimin e konsulentëve;
- c) Përzgjedhja mbi bazën e cilësisë;
- d) Përzgjedhja e një burimi të vetëm; dhe
- e) Buxheti.

D. Rishikimi i bankës për vendimet e prokurimit

1. Programi i prokurimit do të përcaktojë ato kontrata, të cilat do të jenë subjekt i Rishikimit/Vlerësimit Paraprak të Shoqatës. Të gjitha kontratat e tjera do të jenë subjekt i Rishikimit/Vlerësimit të Mëpasshëm nga Shoqata.

PJESA V TËRHEQJA E TË ARDHURAVE NGA FINANCIMI

A. Të përgjithshme.

1. Marrësi mund të tërheqë të ardhurat/përfitimet e financimit në përputhje me parashikimet e nenit II të kushteve të përgjithshme, parashikimeve të kësaj pjese, si dhe instruksione/udhëzime të tilla shtesë të cilat mund të nxjerrë Banka në vëmendje të Marrësit, për financimin e Shpenzimeve të Miratuara ashtu siç janë parashikuar/cilësuar në tabelë, në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme cilëson/ përcakton kategorinë e Shpenzimeve të Miratuara (Miratuara), të cilat mund të financohen nga të ardhurat/përfitimet e financimit ("Kategoria"), transfertat e shumave të kreditit tek kjo Kategori, si dhe përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen për Shpenzime të Miratuara në Kategori:

Kategoria	Shuma e Kredisë së shpërndarë (shprehur në ekuivalentë SDR)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1. Mallra, punime, shërbime konsulence duke përfshirë dhe auditimin. Kosto trajnimi dhe operacionale të përfshira në ARP-në respektive për vitin 2006 dhe vitet kalendarike në vijim.	10,500,000	Një përqindje e tillë e shpenzimeve të miratuara që mund të përcaktojë Shoqata për çdo vit kalendarik, duke filluar në vitin kalendarik 2006, të mbuluara nga PVR përkatëse.
Shuma total	10,500,000	

B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes.

1. Pavarësisht nga parashikimet/kushtet e pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk mund të bëhet për pagesat e bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje.

2. Të ardhurat e tërhequra nga financimi, siç janë përcaktuara në PVR përkatëse, do të depozitohen në një llogari në monedhë të huaj, e cila hapet dhe mbahet nga Thesari i Marrësit në Bankën Kombëtare të Shqipërisë. Pas transfertës në këtë llogari, Thesari i Marrësit do të depozitojë vlerën e barazvlefshme në lekë në Llogarinë e vetme të Thesarit të pacilësuar në lekë, shumë e cila do të përdoret për financimin e Shpenzimeve të Pranueshme nën këtë Projekt, ashtu siç janë identifikuar në PVR-në respektive.

3. Data e mbylljes është 31 dhjetor 2010.

PROGRAMI 3 PROGRAMI I RIPAGESËS

Afati i fundit për pagesën	Shuma principale (fillestare) e Kredisë për t'u rikthyer (ripaguar) (e shprehur në përqindje)*
Në çdo 1 mars dhe 1 shtator:	
duke fluar nga 1 shtator 2016 deri në dhe duke përfshirë 1 mars 2026.	5%

*Përqindjet përfaqësojnë përqindjen e shumës së principalit të Kredisë, e cila duhet të kthehet (ripaguhet) përveçse në rastet kur Shoqata mund ta specifikojë/cilësojë ndryshe në përputhje me pjesën 3.03 (b) të kushteve të përgjithshme.

SHTOJCË

PJESA I PËRKUFIZIME

1. “Studimi PISA 2009” nënkupton Programin e OECD për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (Programme for International Student Assessment), i cili do të zbatohet në 2009.

2. Me “Program Vjetor të Reformës” ose “PVR” do të kuptohet çdo listë e veprimtarive vjetore të mbështetura nga Projekti dhe të përgatitura nga Marrësi, për të cilat është rënë dakord ndërmjet Marrësit, Shoqatës dhe Partnerëve për Zhvillim (siç janë përcaktuar më poshtë), në përputhje me pjesën II.2 të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Me “Procesi i Bolonjës” do të kuptojmë hapat për të cilat është rënë dakord në përputhje me Deklaratën e Bolonjës mbi Hapësirën Europiane për Arsimin e Lartë, e cila daton 19 qershor 1999, nënshkruese e të cilës është edhe Shqipëria.

4. Me “Kategori” do të kuptojmë një kategori të paracaktuar në tabelën e pjesës V të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Me “Marrëveshje Bashkëfinancimi CEDB” do të kuptohet marrëveshja e cila do të lidhet ndërmjet Marrësit dhe Këshillit Europian për Zhvillim e mbështetje/ndihmë financimit të Projektit.

6. Me “Udhëzime për konsulentin” do të kuptojmë “Udhëzimet: Përzgjedhja/përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore” e botuar nga Banka në maj 2004.

7. Me “Partnerë të zhvillimit” do të kuptojmë nënshkruesit e MM (MOU) (të cilësuar si më poshtë).

8. Me “Drejtoria Rajonale e Arsimit” do të kuptojmë drejtorinë rajonale të MASH dhe

përfshijnë çdo pasues (trashëgimtar) të tyre.

9. “Dollarë” dhe “\$” nënkuptojnë dollarë amerikanë të SHBA.

10. Me “Marrëveshje bashkëfinancimi EIB” do të kuptohet marrëveshja e cila do të lidhet ndërmjet Marrësit dhe Bankës Europiane për Investime në mbështetje/ndihimë të financimit të Projektit.

11. Me “Plan menaxhimi mjedisor” do të kuptohet programi i përshtatur nga Marrësi në datën 15 mars 2006 në përputhje me kushtet/pritshmëritë e Shoqatës, në përputhje me kushtet për përmirësimin, monitorimin dhe masat institucionale që duhet të ndërmerren për eliminimin e ndikimeve të padëshirueshme mjedisore dhe sociale, përmirësimi/kompensimi i tyre, reduktimi i tyre deri në nivele të pranueshme, si dhe veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre masave.

12. “Plani për forcimin e kapaciteteve të besueshmërisë” do të thotë plane veprimi specifike brenda një afati të caktuar, të përgatitura nga MASH dhe të pranuar nga Shoqata, për përmirësimin e kapaciteteve të menaxhimit financiar dhe prokurimit në MASH dhe në agjencitë zbatuese në varësi, në nivel kombëtar dhe lokal, dhe përfshin trajnimet e duhura të stafit dhe masat për përmirësimin e sistemeve të besueshmërisë:

13. “Kushte të përgjithshme” do të thotë/nënkupton “Kushtet e Përgjithshme për Kredi dhe Grante të Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar”, e datës 1 korrik 2005.

14. Me “Ligji për arsimin e lartë” do të kuptojmë ligjin nr.8461 “Mbi arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i datës 25 shkurt 1999 që ka Marrësi.

15. Me “Institut të Kurrikulave dhe Standardeve” do të kuptojmë Insitutin e Marrësit që merret me zhvillimin dhe mbikëqyrjen e kurrikulave dhe standardeve të shkollës, e themeluar kjo me vendim të Këshillit të Ministrave të Marrësit nr.654, në datën 6 shtator, 2003.

16. “Lekë” nënkupton monedhën zyrtare të Shqipërisë.

17. Me “Master Plan për Arsimin e Lartë” do të kuptojmë programin strategjik që ka Marrësi për reformën në arsimin e lartë, e cila është përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH).

18. Me “Memorandum Mirëkuptimi” ose “MM (MOU)” do të kuptojmë memorandumin e mirëkuptimit të datës e cilësuar më poshtë nënshkruar ndërmjet Shqipërisë dhe Partnerëve për Zhvillim, të cilët bien dakord *inter alia*, për procedura të përbashkëta mbi prokurimin, disbursimin, menaxhimin financiar, masat mbrojtëse mjedisore, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit për sa i përket/në lidhje me mbështetjen financiare të Projektit.

19. Me “Ministri e Arsimit dhe Shkencës” ose “MASH” do të kuptojmë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Marrësit dhe përfshin çdo pasues (trashëgimtar) të saj.

20. Me “Ministri e Financave” do të kuptojmë Ministrinë e Financave të Marrësit dhe përfshin çdo pasues (trashëgimtar) të saj.

21. Me “Ministri të Punëve të Brendshme dhe Decentralizimit” do të kuptojmë Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Decentralizimit të Marrësit dhe përfshin çdo pasues (trashëgimtar) të saj.

22. Me “Ministri të Punës dhe Çështjeve Sociale” do të kuptojmë Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale të Marrësit dhe përfshin çdo pasues (trashëgimtar) të saj.

23. Me “Banka Kombëtare e Shqipërisë” do të kuptojmë Bankën Kombëtare të Marrësit dhe përfshin çdo pasues (trashëgimtar) të saj.

24. Me “Qendër Kombëtare e Vlerësimit” do të kuptojmë qendrën për vlerësim të Marrësit, e cila është themeluar në 12 maj 2001, në bazë të vendimit nr.309 të Këshillit të Ministrave të Marrësit.

25. Me “Manual të Veprimit/Operacional” ose “MO” do të kuptojmë dokumentin e përshkruar në dokumentin e përmendur në pjesën 5.01 (c) të kësaj Marrëveshjeje, sipas kërkesës (pritshmërive) të Shoqatës, e cila vendos për procedurat e menaxhimit financiar (buxhetimin, mbajtjen e llogarive/financa dhe kontrollin e brendshëm, disbursimin dhe transferimin e fondeve, raportimin financiar, raportet vjetore dhe procedurat e kontroll revizionit (auditimit) të brendshëm dhe të jashtëm), si dhe rregullimet institucionale për zbatimin e Projektit. Ky manual mund të ndryshohet herë pas here në bazë marrëveshjeje ndërmjet Shoqatës dhe Marrësit.

26. Me “Udhëzime për prokurime” do të kuptojmë “Udhëzimet për prokurime për huadhëniet e BERZH dhe kreditë e OZHN (IDA)” e botuar nga Banka në maj 2004.

27. Me “Plan prokurimesh” do të kuptojmë programin e prokurimeve të Marrësit për Projektin, i cili daton 17 prill 2006 sipas parashikimit në paragrafin 1.16 të udhëzimit për prokurimet

dhe paragrafin 24 të udhëzimit për konsulencën, e cila do të përditësohet herë pas here në përputhje me parashikimet e bëra në paragrafët e sipërpërmendur.

28. Me “Program” do të kuptojmë fazën e parë të strategjisë kombëtare për arsimin që ka Marrësi, e cila daton 15 shkurt 2006.

29. Me “Ligji shqiptar për prokurimin publik” do të kuptojmë ligjin që ka Marrësi me nr.7971, të datës 26 korrik 1995, i ndryshuar së fundmi me ligjin nr.9372, data 14 prill 2005.

30. Me “Qendra Arsimore për Trajnim dhe Kualifikim” do të kuptojmë Qendrën e Marrësit, e cila merret me trajnimin dhe kualifikimin e mësuesve, e cila është themeluar më 25 shtator 2003, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të Marrësit me nr. 655.

31. “Këshilli i qarkut” nënkupton këshillin e qarkut (rajonal) të Qeverisë së Shqipërisë.

32. “Drejtori Rajonale e Arsimit” nënkupton drejtorinë rajonale të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH).